

**VENDIM**  
**Nr. 87, datë 30.1.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT, CERTIFIKIMIT DHE TESTIMIT TË FARAVE FORAGJERE<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM Nr. 319, datë 27.4.2016)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9 të nenit 4, të pikës 3 të nenit 14, të pikës 3 të nenit 15, të pikës 4 të nenit 16, të pikës 4 të nenit 17, të pikës 1 të nenit 18 dhe të nenit 33 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farave foragjere e të farave foragjere të përziera, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e farave foragjere, rregullat e paketimit e të etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim, si dhe procedurën e testimit e provat krahasuese për kontrollin e farave foragjere që vendosen në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

**II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE FORAGJERE**

1. Kriteret për tregtimin e farave foragjere dhe farave foragjere të përziera

Kriteret që duhet të plotësojë fara foragjere dhe fara foragjere e përzier për tregtim janë:

a) Të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë sipas kërkesave të këtij vendimi;  
b) Të jenë të pajisura me certifikatën zyrtare sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Të jenë të paketuara dhe të etiketuara në përputhje me kriteret e pikës 3 të këtij kreu;  
ç) Varieteti ose hibridi prej të cilit është prodhuar fara të jetë i regjistruar në Katalogun Kombëtar;

d) Farat foragjere të përziera të kenë në përbërje të tyre jo më pak se dy specie ose varietete të ndryshme, sipas kërkesës së furnizuesit dhe qëllimit të përdorimit;

dh) Farat foragjere të përziera të përmbajnë si përbërës të përzierjeve të tyre vetëm fara nga bimët foragjere të listuara në shtojcën VII të këtij vendimi;

e) Përzierjet mund të përmbajnë fara të bimëve foragjere dhe fara të bimëve që s'janë bimë foragjere në kuptimin e këtij vendimi, në rastet kur përdoren për ruajtjen e mjedisit natyror në funksion të mbrojtjes së burimeve gjenetike;

ë) Të plotësojnë kërkesat e legjislationit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave foragjere

2.1 Sipas prejardhjes, farat foragjere ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Fara parabazë;
- b) Fara bazë;
- c) Riprodhimi i parë;
- ç) Riprodhimi i dytë.

---

<sup>1</sup>Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 66/401/KEE të Këshillit, datë 14 qershor 1966 "Për tregtimin e farave foragjere"; numri CELEX 31966LO401, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr. 125, datë 11.7.1966, faqe 2309-2319.

2.2 Farat parabazë përfitohen nga shumëzimi i farave në farishten e shumëzimit të farave të zgjedhura nën përgjegjësinë e seleksionerit për mbrojtjen e varietetit.

2.3 Farat bazë përfitohen nga shumëzimi i farës parabazë, nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas metodave të seleksionimit për mbrojtjen e varietetit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.4 Fara të riprodhimit të parë janë farat foragjere që përfitohen nga shumëzimi i farave bazë ose, nëse e përcakton seleksioneri, nga fara e një riprodhimi më të hershëm se fara bazë dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.5 Fara të riprodhimit të dytë përfitohen nga shumëzimi i farave të riprodhimit të parë ose, nëse e përcakton seleksioneri, nga fara të një riprodhimi më të hershëm dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.6 Farat foragjere të riprodhimit të parë dhe riprodhimit të dytë futen në kategorinë fara të certifikuar.

2.7 Skemat e prodhimit të kategorive të farave foragjere, sipas grupimit të bimëve (bimë vetëpëlluese dhe të kryqëzuara), është detyrë e institucioneve shkencore dhe individëve të veçantë nën monitorimin dhe përgjegjësinë e ESHFF-së.

2.8 Identiteti i farave foragjere është tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike, si dhe qëllimi i përdorimit të një specie të caktuar për ta dalluar nga speciet e tjera. Bimët, nga të cilat prodhohen farat foragjere sipas kriterëve të këtij vendimi, janë përcaktuar në shtojcën VII bashkëlidhur.

2.9 Cilësia e farave foragjere përcaktohet nga këta tregues:

a) Pastërtia e përgjithshme, e cila është pesha në përqindje e farave të pastra ndaj peshës së përgjithshme të farës;

b) Fuqia mbirëse, e cila është aftësia e farës për të mbirë në kushte të caktuara dhe përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vënë për mbirje;

c) Energjia mbirëse, e cila është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar (sipas Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farërave, ISTA) dhe shprehet në përqindje;

ç) Lagështia e farave, e cila është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara për t'u paketuar dhe për t'u tregtuar si material mbjellës.

2.10 Normat për treguesit cilësorë të farave foragjere janë të përcaktuara në tabelën A të shtojcës II.

3. Paketimi dhe etiketimi i farave foragjere

3.1 Paketimi i “farës bazë” dhe “farës së certifikuar” të çdo kulture dhe lloji shoqërohet me dy lloji etiketash, që janë etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare që përgatitet dhe lëshohet në treg nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara foragjere është certifikuar dhe kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Farat foragjere të kategorive “farat bazë” dhe “farat e certifikuar”, të tregtohen vetëm në lote homogjene të mbyllura me paketim.

3.3 Paketimet e “farave bazë” dhe “farave të certifikuar” të çdo kulture dhe lloji duhet të kryhen në mënyrë të tillë që nëse hapen, mbyllja ose vetëpaketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Ripaketimi i farave foragjere bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik për verifikimin e cilësisë së farës me kërkesë të furnizuesit. Nëse ripaketohet, ripaketimi dhe data e ripaketimit duhet të shënohet në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Paketat e “farave parabazë”, “farave bazë” dhe të “farave të certifikuar” të çdo lloji duhet:

a) të jenë të pajisura në pjesën e jashtme me një etiketë zyrtare, që plotëson kushtet e përcaktuara në shtojcën IV dhe në gjuhën shqipe;

b) të përmbajë një dokument zyrtar, në të njëjtën ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë të paktën informacionin e kërkuar në shtojcën IV, (I) (a) (3), (4) dhe (5). Ky dokument duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën zyrtare të përmendur në shkronjën “a”.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i “farës bazë” apo “farës së certifikuar” të çdo lloji përmban edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Farat e shumëzuara nga riprodhimet e “farës parabazë” mund të tregtohen si “fara bazë”,

“fara të certifikuara”, “fara të certifikuara të riprodhimit të parë” dhe “fara të certifikuara të riprodhimit të dytë” kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të jenë kontrolluar zyrtarisht nga autoriteti certifikues në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e “farës bazë”;

b) Të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) Paketat duhet të kenë etiketën zyrtare, ku të shënohen të paktën të dhënat e mëposhtme:

i) autoriteti certifikues dhe shteti përkatës ose shkurtimet e tyre dalluese;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i vulosjes; ose

iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;

v) speciet, duke shënuar të paktën emrin botanik të tyre, të cilët mund të jepen në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit;

vi) varieteti të shënohet të paktën me karaktere latine;

vii) të dhënat për “farën parabazë”;

viii) riprodhimi;

ix) të jetë e bardhë me një vijë diagonale vjollcë.

3.8 Paketat e vogla të farave foragjere duhet:

a) të mbajnë në pjesën e jashtme etiketën e furnizuesit, një përshkrim të shtypur në gjuhën shqipe, në përputhje me përcaktimet e shtojcës IV. Kur paketat janë transparente, kjo etiketë mund të vendoset brenda ambalazhit, me kusht që të jetë i mundur leximi. Ngjyra e etiketës do të jetë sipas përcaktimit të pikës 3.7 shkronja “c” nëndarja “ix” të këtij kapitulli;

b) të mbajnë në pjesën e jashtme ose në etiketën e furnizuesit një numër të caktuar serial zyrtar.

3.9 Çdo trajtim me plehrat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, që i është bërë “farave bazë” dhe “farave të certifikuara”, shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V.

### III. CERTIFIKIMI I FARAVE FORAGJERE

#### 1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të farave foragjere realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private sipas përcaktimit në kreun IX të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave foragjere të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre janë, si më poshtë vijon:

a) Për certifikimin e farave foragjere pranë autoritetit certifikues duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

i) Kërkesa me shkrim për certifikimin e farës foragjere;

ii) Licenca përkatëse e lëshuar nga QKL-ja;

iii) Aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimin e kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat foragjere dhe modelit të dhënë në shtojcën V;

iv) Certifikata e origjinës që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

v) Certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;

vi) Aktaprobimi fushor;

vii) Fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laborator i miratuar nga ministri;

viii) Etiketa e prodhuesit;

ix) Deklarata e konformitetit;

b) Autoriteti certifikues për procedurën e certifikimit ndjek hapat, si më poshtë vijon:

i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës foragjere, që do të certifikohet si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e sipërpërmendur, plotëson procesverbalin për “Verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës foragjere”;

ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të

sipërpërmendur;

iii) Gjatë vlerësimit të dosjes, duhet të mbahet parasysh që përmbajtja maksimale e lagështirës për “farat bazë” dhe “farat e certifikuar” të të gjitha llojeve të jetë jo më shumë se 14%;

iv) Në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

v) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

vi) Elementet dhe kriteret e etiketës duhet të jenë sipas ndarjes “A” të shtojcës IV të këtij vendimi;

vii) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr e plotësuar nga prodhuesi sasi të etiketave zyrtare.

1.3 Procedurat për certifikimin zyrtar të farave foragjere të përziera kryhet veçmas për çdo përbërës dhe bazohet në procedurën që aplikohet për certifikimin e farave sipas pikës 1.2 më sipër. Në të dhënat e etiketës zyrtare dhe të etiketës së prodhuesit krahas treguesve të tjerë shënohet “farë e përzier”, si dhe raporti i përbërësve në përzierje. Certifikata zyrtare për farat foragjere të përziera plotësohet pas tërheqjes së etiketave zyrtare për këtë kategori farash. Etiketa e paketave të farave foragjere të përziera është me ngjyrë jeshile.

1.4 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.5 Për rastet kur ESHFF-ja autorizon kryerjen e procedurave të certifikimit dhe subjekti i autorizuar nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesë pranë ESHFF-së.

1.6 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesën pranë Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

1.7 Farat e bimëve foragjere të renditura më poshtë, nuk mund të hidhen në treg si fara foragjere të përziera, nëse nuk janë të certifikuar zyrtarisht si “farë bazë” ose “farë e certifikuar”,

|                                                                                   |                              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| Brassica napus L. napobrassica                                                    | Sinapi;                      |
| Brassica oleracea L.                                                              | Lakra e zakonshme;           |
| Dactylis glomerata L.                                                             | Telishi lëmshor;             |
| Festuca arundinacea                                                               | Bishtpelëza si kallam;       |
| Festuca pratensis                                                                 | Bishtpelëza e livadhit;      |
| Festuca rubra L. × Festulolium                                                    | Bishtpelëza e kuqe;          |
| Galega orientalis Lam.fodder galega                                               | Bar qerbashi;                |
| Lolium multiflorum Lam.                                                           | Egjëra shumëlulëshe;         |
| Lolium perenne L.                                                                 | Egjëra shumëvjeçare;         |
| Phleum pratense L.                                                                | Fleumi i livadhit;           |
| Medicago sativa L.                                                                | Jonxha;                      |
| Medicago × varia T. Martyn                                                        | Jonxha hibride e ranishtave; |
| Pisum sativum L.                                                                  | Bizelja e zakonshme;         |
| Raphanus sativus L. var. oleiformis Pers. rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere |                              |
| Trifolium repens                                                                  | Tërfili i bardhë rrëshqanor; |
| Trifolium pratense L.                                                             | Tërfili i kuq/ i livadheve;  |

1.8 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim të farave foragjere dhe farave foragjere të përziera është sipas shtojcës V të këtij vendimi.

## 2. Kriteret e ruajtjes, marrja e mostrave dhe analiza e farës për certifikim

2.1 Farat foragjere duhet të mbahen në mjedise të përshtatshme, në të cilat, gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit, sigurohen temperatura dhe lagështira optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë për farat foragjere dhe farat foragjere të përziera. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farave foragjere. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratim higjieno-sanitar, të lëshuar nga strukturat vendore të shëndetit publik, si dhe

me certifikatën DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), të lëshuar nga subjekte të licencuara sipas legjisllacionit në fuqi. Farat foragjere nuk duhet të mbahen në ruajtje më shumë se 3 (tre) vjet.

2.2 Fara foragjere dhe farat foragjere të përziera tregtohen si të tilla vetëm pasi të jenë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Gjatë përpunimit, farat foragjere mund të dezinfektohen e të peletohen me pesticide e lëndë kimike, ushqyese, kjo e shoqëruar me shënimin në etiketën përkatëse.

2.3 Furnizuesve të farave foragjere u lejohet që në mjediset e tyre të përpunojnë, të paketojnë dhe të etiketojnë fara foragjere edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e farave foragjere.

2.4 Procesi i analizës laboratorike të farave foragjere për certifikim ushtrohet mbi:

a) lotin e farës, si një sasi e dhënë fare foragjere, e një riprodhimi dhe e një kategorie që ka pastërti varietore të caktuar;

b) mostrën, si një sasi fare e marrë në një ose në disa pika të lotit të farës;

c) kampionin fillestar, si një sasi fare foragjere që del nga përzierja e mostrave;

ç) kampionin mesatar si një pjesë e kampionit fillestar;

d) provën si një pjesë e kampionit mesatar, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën III të këtij vendimi.

2.5 Mostrat e farave për analizën e farave foragjere, për qëllim certifikimi, duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar nga ESHFF-ja, në përputhje me metodat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2.6 Për ekzaminimin e farës foragjere për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre janë dhënë në shtojcën III të këtij vendimi.

#### IV. PROCEDURAT DHE METODAT E TESTIMIT TË VARIETETEVE QË REGJISTROHEN NË KATALOGUN KOMBËTAR

*(Shfuqizuar me VKM Nr. 319, datë 27.4.2016)*

#### V. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohet Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF) dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**